

# MARRËVESHJET FORWARD, NË SHQIPËRI KA ENDE BOSHLLËK LIGJOR

**N**ë Shqipëri ka ende boshllëqe ligjore që frenojnë zhvillimin e marrëveshjeve forward të këmbimit valutor. Në një intervistë për "Monitor", Ilirjan Ligaçaj, Drejtor i Departamentit të Thesarit në Union Bank, thotë se këto instrumente funksionojnë në treg mbi bazë të disa marrëveshjeve-kuadër të hartuara nga shoqata të ndryshme ndërkombëtare të sektorit financiar.

**Çfarë janë marrëveshjet forward të këmbimit valutor? Cilat janë zakonisht afatet maksimale që parashikojnë këto marrëveshje?**

Marrëveshjet forward të këmbimit valutor janë një instrument financiar derivativ, që ka si objekt kryerjen e një transaksioni këmbimi valutor, në një datë të ardhshme dhe me një kurs këmbimi të përcaktuar që në momentin e arritjes së marrëveshjes mes blerësit dhe shitësit. Quhet instrument derivativ, pasi bazohet në një instrument tjetër, që është kursi i këmbimit SPOT (kursi në momentin e arritjes së marrëveshjes). Duhet theksuar se, megjithëse kemi të bëjmë me një kurs këmbimi të fiksuar për një datë të ardhshme, nuk kemi të bëjmë me një parashikim, por me një llogaritje që bazohet te dy elemente:

- Kursi i këmbimit SPOT (që e sqaruar më sipër)
- Diferenca e normave të interesit mes dy monedhave që janë objekt i transaksionit të këmbimit.

Duke qenë një instrument që negociohet mes palëve, ai ka një fleksibilitet të plotë për sa u përket detajeve. Për këtë arsye, spektri i afateve për të cilat ofrohet ky instrument mund të shkojë nga disa ditë, deri në një vit. Më tipike janë afate fikse 1, 3, 6 apo 12-mujore për efekt të një lehtësie më të madhe llogaritje por, palët mund të vendosin mes tyre për çdo afat për të cilin bien dakord.

**A ofrohen aktualisht marrëveshjet forward nga bankat tregtare në Shqipëri dhe cilat mund të jenë avantazhet dhe përfitimet e tyre për palët?**

Nga informacionet që kemi, marrëveshjet forward ofrohen në një numër shumë



të kufizuar. Këto transaksione kryesisht shërbejnë si një instrument për zbutjen e riskut (të këmbimit në këtë rast). Për rrjedhojë, përfitimi kryesor i palës që e përfton këtë instrument është minimizimi i rrezikut të këmbimit.

Ky instrument të ofron që një madhësi të përcaktuar (kursi i këmbimit në një datë të ardhshme) ta kthesh në një madhësi të përcaktuar (kursi forward). Në këtë mënyrë, një biznes nuk e lë veten në mëshirën e ecurisë së kursit të këmbimit por, duke kryer një transaksion forward, përfton një kurs të përcaktuar mbi të cilin mund të bëjë llogari të sakta lidhur me biznesin.

**Cilat janë arsyet që deri më sot këto marrëveshje nuk janë shumë të njohura dhe të përdorura nga sektori privat në Shqipëri?**

Ka një problem thelbësor lidhur me ofrimin e instrumenteve derivative në përgjithësi në Shqipëri. Këto instrumente funksionojnë në treg mbi bazë të disa marrëveshjeve-kuadër të hartuara nga shoqata të ndryshme ndërkombëtare të sektorit financiar. Këto marrëveshje-

kuadër përbëjnë bazën rregullatore të kësaj kategorie transaksionesh, pasi marrëveshjet receptohen si pjesë e legjislacionit kombëtar. Kjo gjë në Shqipëri nuk ka ndodhur, kështu që jemi përballë një vakumi ligjor. Për këtë arsye, edhe bankat apo operatorë të tjerë të tregut janë të rezervuar ta ofrojnë këtë instrument apo të tjera me të njëjtën natyrë. Përveç këtij problemi, edhe njohja e këtij instrumenti është e kufizuar. Për shkak të boshllëkut që përmenda dhe rezervimit të bankave përshkruar më sipër, nuk duket të ketë një qasje aktive edhe në drejtim të edukimit të kompanive apo bizneseve në lidhje me përparësitë apo avantazhet që ofrojnë këto instrumente.

**A ka pasur interes nga bizneset për të përdorur marrëveshje forward gjatë këtij viti, me rritjen e luhatshmërisë në kursin e këmbimit valutor?**

Ne si Union Bank nuk kemi evidentuar ndonjë kërkesë të shtuar për kontratat e këmbimit forward. Sigurisht që rritja e luhatshmërisë e bën më akute nevojën për to.

**Për cilët segmente dhe sektorë të biznesit mund të jenë më të dobishme marrëveshjet forward?**

Instrumentet forward janë të përshtatshme për cilindo biznes që kryen këmbime valutore, për shkak të flukseve monetare në monedha të ndryshme të gjeneruara nga veprimtaria e tij. Të gjithë ata që nuk dëshirojnë të marrin përsipër riskun e këmbimit kundrejt një fitimi eventual më të madh (por që mund të shndërrohet lehtësisht në humbje po aq të madhe) do të bënin mirë ta rrisnin interesin e tyre, për të përftuar këto instrumente nga operatorët e tregut.

**Banka e Shqipërisë, në dy vitet e fundit, po aplikon blerje forward në ankandet e saj valutore. A mund të ketë ky mekanizëm një rol në zhvillimin e kontratave forward mes bankave dhe sektorit privat?**

Nuk besojmë se ka pasur apo do të ketë ndonjë ndikim. Që ky treg të zhvillohet, kërkohet, në radhë të parë, rregullimi i kuadrit ligjor për zhvillimin e tij. ■